
VEÇORI THEMELORE TË DUKURIVE GRAMATIKORE NË STILIN JURIDIKO-ADMINISTRATIV NË GJUHËN SHQIPE NË PËRQASJE ME GJUHËT RUSE DHE ANGLEZE

EDA SHEHU

Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Tiranë, ALBANIA

edashehu_2006@yahoo.com

AKTET V, 4: 785-791, 2012

Qysh nga koha kur Charl Bali, mbi një shekull më parë, brenda shkencës së re gjuhësore “Stilistika” të krijuar prej tij, ravijëzoi stilet e gjuhës, e në mënyrë të veçantë, stilin e letërsisë artistike dhe stilet (gjuhët) speciale e deri në ditët e sotme, studimet në fushë të stileve e kanë thelluar e zgjeruar më tej objektin e vështrimit mbi to, si edhe i kanë pasuruar ato me të dhëna të reja. Mund të theksohet se qysh në veprën e Balisë janë veçuar si objekt studimi stilet (gjuhë speciale) që, sipas tij, “kanë terminologji e një frazeologji konvencionale, bashkë me shmangiet e veta gramatikore”. Siç dihet, pas veprës së tij, studimet në fushë të stileve janë përqëndruar në gjuhën e letërsisë artistike dhe në ligjërimin e përgjithshëm, duke mos mos i ndarë prerazi stilistikën gjuhësore nga stilistika letrare. Ndikim këtu kanë patur konceptet e shkollës neogramatikane italiane (Fosler, Taliavini), të shkollës ruse (Vinogradovi), të shkollës frënge etj. Në mënyrë të veçantë, pas viteve 70-të të shekullit të kaluar përcaktimi i kufirit ndërmjet stilistikës gjuhësore dhe asaj letrare edhe në gjuhësinë shqiptare çuan në diferencimin e stileve funksionale në vartësi të funksioneve shoqërore të mjeteve gjuhësore, çka bëri që të thellohej më tej ideja e Balisë dhe e shkollës strukturaliste çeke mbi stilet (gjuhët) e specializuara. Kështu u hap rruga jo vetëm për zbulimin më në thellësi të tipareve të stileve speciale në lidhje me leksikun terminologjik dhe

jotermnologjik, dhe vështrimin e tyre nga ana e shfaqes në to të dukurive gramatikore (të nivelit të fjalëformimit, të morfologjisë dhe të sintaksës). Në mënyrë të veçantë thellimi i studimeve në fushën e terminologjisë së këtyre stileve çoi në konceptin e përbashkët të gjuhës së specializuar me objektin e vet të studimit (Vyster, Piht, Sager) në kundërvënie me gjuhën e përgjithshme, kur të dyja ato, gjuha e specializuar dhe gjuha e përgjithshme, vështrohen tashmë si dy pjesë në përbërje të një të tërë, të gjuhës standarde të çdo vendi.

Studimet në fushën e stileve funksionale në gjuhën shqipe e që përfshihen në kuadrin e gjuhës së specializuar si një e tërë, janë përqëndruar në leksikun terminologjik. Megjithatë përveç trajtimeve për terminologjitë e ndryshme të këtyre stileve, e në mënyrë të veçantë për stilin shkencor teknik, stilin juridiko-administrativ, politiko-shoqëror, në fokusin e vështrimit janë vënë edhe veçoritë e shfaqjes në to të dukurive gramatikore në kuadrin e çdo stili special të veçantë. Ndërmjet tyre një vend të veçantë zë trajtimi i veçorive të këtyre dukurive gramatikore në stilin juridiko-administrativ. Më shumë se në çdo stil tjetër në këtë stil ndikojnë faktorët jashtëgjuhësorë, që lidhen me tiparet e veçanta të sferës së veprimtarisë shoqërore së cilës ky stil i shërben dhe që përbëjnë bazën për mëvetësimin e tij si formim i veçantë stilistik.

Veçoritë e shfaqjes së dukurive gramatikore në stilin juridiko-administrativ kanë tërhequr vëmendjen e studiuesve rreth stileve të gjuhëve të ndryshme, të cilët i kanë bërë ato objekt të trajtimeve të tyre si brenda këtij stili ashtu edhe në përjasje me stilet e tjera të specializuara. Megjithatë është e rëndësishme të theksohet se shfaqja e këtyre veçorive në dukuritë gramatikore lidhet me tiparet e këtij stili, i cili përbën shkallën më të lartë “të ngurtësimit të ndërtimit tërësor gjuhësor të çdo teksti” çka pasqyrohet “në thënie të plota me paraqitje objektive, pa emocionalitet e shprehësi, të sistematizuara e të njëtrajtshme, që kërkojnë të parashikojnë të gjitha anët, e rrethanat, në marrëdhëniet e tyre logjike dhe me përfundimin ose parashkrimin përkatës”. Kjo do të thotë se këtu kihet parasysh si funksioni stilistik kumtues e, në mënyrë të veçantë, ai parashkrimor, që lidhet me atë se çfarë duhet bërë, çfarë urdhërohet të bëhet, duke marrë gjithçka të pandryshueshme. Në këtë rast veçoritë në mënyrën e shikimit të dhënies së përmbajtjes gjejnë pasqyrim në strukturimin e mjeteve gjuhësore të shprehjes, duke përfshirë nivelet fjalëformuese, morfologjike e sintaksore. Ndonëse ky stil është i mbyllur në kufijtë e një gjuhe, shumë struktura ndërtohen edhe sipas modeleve të huaja, por që gjithësesi futen në forma të ngurtësuara, duke ndryshuar kështu mjetet e shprehjes në gjuhët marrëse (*wanted* (angl.) -*kërkohet* (shq.) - *разыскан* (rus.)). Kjo do të thotë se ky stil, duke u ngritur nga ana e strukturimit të përmbajtjes njësoj në të gjitha gjuhët, ai ngjizet në secilën gjuhë e në formë sipas natyrës tipologjike-strukturore të secilës prej tyre. Pra, faktorët jashtëgjuhësorë janë të përbashkët për secilën gjuhë, çka motivojnë dukuritë e përbashkëta, kurse mjetet e realizimit dalin në përshtatje me natyrën e gjuhës, të njëjta (kur gjuhët janë të afërta), të përafërta ose të ndryshme e deri krejtësisht të ndryshme. Kjo do të thotë që krahasimi i veçorive të dukurive gramatikore të këtij stili edhe me gjuhë të tjera, sidomos me gjuhë që shërbejnë si model standardizimi, si anglishtja, rusishtja etj. ndihmon për të hedhur dritë në anë të caktuara edhe të dukurive gramatikore në gjuhën shqipe për

zhvillimin e ngritjes në sistem të tij. Ndonëse ky stil u përvijua si rrjedhim i proceseve të brendshme të zhvillimit të gjuhës shqipe, për përsosjen e tij ndikuan edhe kontaktet me gjuhët e tjera të përpunuara. Ky ndikim u nënshtrua procesit të brendshëm, që çoi në krijimin e strukturave të përshtatura natyrës së shqipes.

Në mënyrë të veçantë në këtë proces për gjuhën shqipe kanë ndikuar edhe modelet e stileve të gjuhëve në kontakt të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, siç kanë qënë në fillim gjuha italiane, (kur gjuha shqipe u bë gjuhë zyrtare e veprimtarisë shtetërore që me aktin e shpalljes së Pavarësisë), më tej gjuha ruse e së fundi angleze. Ndikimin e vet në ngritjen në sistem të këtij stili, sidomos në fushën e terminologjisë, kanë ushtruar edhe kontaktet me gjuhën ruse nëpërmjet literaturës shkencore-teknike ruse (1950-1980). Prandaj merr rëndësi të veçantë përjasja e veçorive gramatikore të këtij stili në gjuhën shqipe me rusishten (si gjuhë sintetiko-analitike, siç është edhe shqipja) dhe me anglishten (si gjuhë kryesisht analitike me prirje sintetike). Gjatë krahasimit mund të vërehet lehtë se ndërsa në shfaqjen e dukurive gramatikore ka korrespondime, në mënyrën e realizimit të mjeteve të shprehjes ka dallime në vartësi nga natyra e gjuhës me të cilën bëhet përjasja.

A. Në rrafshin e fjalëformimit

1. Shfaqjet specifike të dukurive në fushën së gramatikës, sidomos në atë të fjalëformimit, e kanë bazën në tiparet e leksikut terminologjik, në shkallën e lartë të njëkuptimisë së termave, në mënyrë të veçantë të shprehjes të koncepteve të përpikta me kufij të prerë ndërmjet tyre, çka bën që termat të shkarkohen prej ngarkesave subjektivo-vlerësuese e të figurshme. Mungesa tek termat e kuptimeve subjektive-vlerësuese, emocionuese dhe të figurshme bën që të përjashtohen në formimet terminologjike një varg prapashtesash vlerësuese, zvogëluese, keqësuese ose me kuptime të figurshme. Prandaj në të tria gjuhët në kufijtë e këtij stili shfaqen aktive dhe prodhimtare një numër shumë i vogël prapashtesash. Kjo dukuri vihet re sidomos në

gjuhën shqipe e ruse si gjuhë sintetike, si në ndërtimin e termave emra, ashtu edhe në termat mbiemra, folje e ndajfolje. Kështu në shqipe nga 168 prapashtesa të evidentuara vetëm rreth 20-25 janë aktive e prodhimtare në këtë stil në përdorim. Po kështu e njëjta dukuri vërehet afërsisht në rusishte dhe në anglishte. Megjithatë njësitë e formuara me këto prapashtesa dallohen për një denduri të lartë përdorimi, meqë termat e krijuar prej tyre shënojnë konceptet themelore të fushës së dijes në fjalë.

Në të tria gjuhët ka një numër shumë të kufizuar prapashtesash me të cilat formohet një numër i madh njësisish si terma, që dalin në pjesë të ndryshme të ligjëratës, por që vendin kryesor e zënë emrat dhe mbiemrat që shprehin kuptime të ndryshme kategorialë; si emra veprimi, emra abstraktë, mbiemra cilësorë prejëmërorë, mbiemra prejpjesorë me nuanca procesi (veprimi) etj. Këto mund të jenë si dukuri të ngjashme apo të afërta nga një gjuhë në tjetrën ose të ndryshme:

1. Emra prejfoljorë me prapashtesa që shprehin veprim: *-im (-je)* (në shqipe), *-ани(е), -ени(е)* (në rusishte), *-ing, -ion (-tion)* (në anglishte); emra prejmbiemërorë që shprehin kuptime abstrakte: *-(e)si, -(e)ri, -i* (në shqipe), *-ость, -ие, -ство* (në rusishte), emra me prapashtes që shprehin persona veprues: *-es-i, or-* (në shqipe), *-тель* (në rusishte), *-or, -er* (në anglishte) etj.

2. Mbiemra me prapashtesa: *es-e, -or-e* (në shqipe), *-енн, -анн, -н* (në rusishte).

Po kështu tipare të terminologjisë si njëkuptimësia, shkarkimi i terminologjisë nga vlerësimet emocionuese, kanë ndikimin e tyre sidomos në fushën e fjalëformimit në gjuhën angleze, ku dukuria e analitizmit vihet në përdorimin funksional të emrave në rolin e cilësoreve (në pozicion para një ose disa emrave të tjerë), çka në gjuhën shqipe e ruse si gjuhë sintetike, këto funksione i mbulojnë mbiemrat:

law reform-reform ligjore-законная реформа

law society-shoqëri ligjore-законное общество

Këtu vihen re dy dukuri: përdorimi i dendur i mbiemrave të prejardhur (në shqipe dhe rusishte) dhe përdorimi më i rrallë i mbiemrave të prejardhur në anglishte (ku në rolin e tyre dalin

kryesisht emra). Në përgjithësi emrave në anglishte i përgjigjen formime mbiemërore në shqipe dhe në rusishte: *state: shtetëror, государственный, law:ligjor, законный; right: e drejta, правовой; tax:налоговый, tatimor.*

B. Në rrafshin e morfologjisë

1. Mungesa e vlerësimeve subjektive vetjake në dhënien informacionit juridiko-administrativ çon në përjashtimin e përdorimit si mjete shprehjeje të vetës së parë e të dytë, njëjës e shumës (si subjekte vepruese) *unë-ti /ne-ju* në të tria gjuhët, por edhe në përdorimin rrallë të vetës të tretë njëjës e shumës si element anaforik (zëvendësues) për persona veprues, të cilët nuk përdoren ose kur përdoren takohen rrallë në tekste të praktikës juridiko-administrative. Në këtë rast më shpesh vihet re përsëritja në fjalinë pasardhëse e njësive që dalin në rolin e kryefjalës (si njësi njëfjalëshe ose togfjalëshe).

Mund të sjellim disa shembuj me fjalë që vijnë njëra pas tjetrës, ku vërehet ose zëvendësimi anaforik i emrit në fjalinë paraprake ose përsëritje e tyre. Këtu kemi një dukuri të dyfishtë: përdorimin anaforik si shprehje të ekonomisë së gjuhës, ashtu edhe ngopjen referenciale me përsëritjen e elementeve të njëjtë brenda tekstit në fjali që vijnë njëra pas tjetrës.

Në shqipe: *Me fjalë të tjera Gjykata e Kasacionit nuk mund të marrë sërish në shqyrtim faktet...*

→Ndërtimi dhe analizimi i fakteve të bëra nga gjyqtarët e ... →Gjykata e Kasacionit mund të shqyrtojë...

Në rusishte: *Конституционное право как отрасль права.→Это Конституционное право как наука...*

Në anglishte: *The code goes beyond the Common law... →It does not authorize... →*

The code also authorizes... →The code encourages.-

2. Prania e objekteve (koncepteve) që lidhen me veprime (procese) me kuptime të paaktualizuara në kohë, bën që tipari i kohës i shprehur prej foljes të ketë gjithashtu vlerë përgjithësuese, të paspecifikuar në kohë të caktuar, duke shprehur kështu një kohë kryesisht të tanishme të përgjithësuar. Pothuajse në çdo tekst të këtij stili

përdoren foljet në kohën e tanishme në të tria gjuhët. Përdorimi i kohës së shkuar shfaqet si rast i rrallë, në rastin kur përshkruhet ndonjë situatë e kohës së shkuar, që paraqitet si shmangie nga tematika e tekstit.

Në shqipe: *Ligji kushtetues parashikon ... → Kjo dizpozitë zbatohet ... → Ky parim nënkupton ...*

Në rusishte: *Конституционное право является ... → Его особенность заключается ... → Основа права предопределяет ... →*

Në anglishte: *... Law must be ... → Enforcement begins ... → When prosecution results ...*

3. Prania e kohës së tanishme të përgjithësuar bën që koha e ardhme të ketë funksionin e kohës së tanishme, kurse koha e shkuar, siç u pohua më lart, përdoret në raste të rralla si shmangia nga tematika:

Në shqipe: *Kjo do të trajtohet më poshtë (=trajtohet); Kjo u sanksionua në kushtetutën e vitit 1976.*

Në rusishte: *Сессия будет одобрятьСессия одобрила этот закон ...*

Në anglishte: *A number of provisions will be establishedDue process was written into English law...*

4. Shprehja e veprimeve me kohë të përgjithësuar të pacaktuar bën që të takohen mënyra dëftore e foljes dhe më rrallë mënyra lidhore e drejtuar kryesisht nga folja paravepruese ose nga fjala që e drejton foljen. Mënyra lidhore në të tria gjuhët përbën struktura tipike, të cilat janë karakteristike për secilën prej tyre. Mënyrat e tjera të foljes, siç janë mënyra habitore, që përbën veçori për shqipen dhe që mungon në të dyja gjuhët e tjera, mënyra kushtore dhe dëshirore, për shkak të shprehjes prej tyre të vlerësimeve subjektive të folësit, nuk gjejmë përdorim në asnjë gjuhë, por mund të përdoren në funksione performative. Në funksione performative, që nuk kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me informacionin shkencor-teknik të tekstit, përdoren, në vartësi nga mundësia për t'i përdorur mjetet e tjera shprehëse, edhe a) e ardhmja e shkuar b) format modale të kohës së shkuar për dhënien e mënyrave kushtore ose dëshirore:

Në shqipe: *Në këtë rast do të vështrohej (do të mund të vështrohej...)*

Në rusishte: *В этом случае был бы рассмотрен/ могло быть рассмотрено...*

Në anglishte: *In this case it would be treated/ might be treated...*

5. Prania e veprimeve në kohë të përgjithësuar të pacaktuar, bën që aspekti kohor të zbehet tek format e pashtjella të foljeve pothuajse në të tria gjuhët dhe në këtë mënyrë tek to përfordhet tipari cilësues në raport me fjalën (emrin) që përcaktojnë.

Siç shihet kjo zbehje e tiparit kohor real fillon qysh prej foljes dhe pothuajse çohet deri në skajshmëri kur pjesorja përdoret para një emri. Në disa raste kemi korrespondim të mjeteve tipike të shprehjes në gjuhët e krahasuara.

Në shqipe: *ligji përcakton-(përcaktohet)- ligji i pacaktuar – ligji përcaktues*

Në rusishte: *закон определяют (определяется)- определённый закон- определяющий закон.*

Siç mund të shihet në të tria gjuhët pjesoret dalin në rolin e mbiemrit çka si dukuri del më e spikatur në gjuhën shqipe, ku pjesoret dhe gjerundi i anglishtes, shfaqen si mbiemra në gjuhën shqipe: *определённый/ determined*: në shqipe: *i pacaktuar (ligji i pacaktuar), определяющий/ determining*: në shqipe: *përcaktues-e (ligji përcaktues)*.

6. Kryerja e veprimit nga ana e objektit në mënyrë të drejtpërdrejtë (aktive) dhe në mënyrë jo të drejtpërdrejtë (pasive) bën që të kemi bashkëlidhje të formës aktive dhe pasive të dhënies së këtyre raporteve me mbizotërimin e formës pasive në këtë stil. Format përkatëse kanë korrespondime në secilën nga gjuhët, ndonëse, sipas natyrës së secilës, ngjashmëria, afërsia ose përngjashmëria me mjetet e shprehjes pasqyrohen në mënyra të ndryshme:

Në shqipe: *Parlamenti miraton ligjin → Ligji miratohet nga parlamenti*

Në rusishte: *Парламент одобряет закон → Закон одобряется парламентом.*

Në anglishte: *Parliament approves the law → The law is approved by parliament.*

Siç mund të vërehet nga korrespondimet e formave të shprehjes shqipja me rusishten përngjashmohet me foljen në format pësore të afërta (*mirato-het* dhe *одобряет-ся*) por diferencohet nga rusishtja dhe afrohet me anglishten në shprehjen e emrave pas foljes me parafjalët përkatëse: *nga* dhe *by*. Nga ana tjetër anglishtja ka forma vetjake të shprehjes së foljes me strukturë të përbërë (analitike: *is approved*) dhe me strukturë sintetike me shqipen dhe me rusishten (*miratohet = утверждается*).

7. Mbizotërimi i përdorimit të objekteve (koncepteve) që kanë ndërmjet tyre raporte të ngurtësuar (struktura stereotipe) kushtëzon përdorimin e emrave prejfoljorë, të cilët si rregull bartin dy kuptime kategoriale kryesore ose të veprimit ose të rezultatit të veprimit dhe ndonjëherë të objektit. Në këto raste kemi një bashkëlidhje të rregullt të foljeve (foljeve, të cilat përdoren rrallë dhe të emrave, të formuar prej tyre, me përdorim më të shpeshtë të cilët mund të kenë kuptimet kategoriale të mësipërme pak a shumë në të tria gjuhët):

shq. *vendos-vendim* (proces dhe rezultat)- *vendim* (objekt, tekst i shkruar)

rus. *решать-решение* (proces dhe rezultat) – *решение* (objekt, tekst i shkruar)

ang. *decide-decision* (proces dhe rezultat) – *decision* (objekt, tekst i shkruar)

8. Vendosja varg e objekteve në bazë të përkatësisë dhe më rrallë të hierarkisë së lidhjes së tyre në seri në kushtëzon përdorimin e shpeshtë të rasës gjinore në shumicën e rasteve sipas strukturës emër prejfoljor + emër në rasën gjinore, që plotësohet më tej me një varg emrash në rasën gjinore mbi 2-3 element deri 4. Kjo është dukuri e përbashkët për të tria gjuhët, ndonëse rendi i elementeve mund të varijojë në vartësi të natyrës së gjuhës. Si rregull në gjuhën shqipe vendosen emrat njëra pas tjetrës, sikurse edhe në rusishte, kurse në anglishte vendosen para pjesës së përcaktuar sipas një hierarkie ku i fundit në shqipe dhe rusishte është i pari në anglishte. Po marrim një shembull me paraqitje të skajshme:

	0	1	2	3	4
5		6			

shq. *pjesa e vendimit të nenit të ligjit të Kushteutës së Republikës së Shqipërisë*

	0	1	2	3	4
--	---	---	---	---	---

5	6				
---	---	--	--	--	--

rus. *часть решения статьи закона Конституции Республики Албания*

		6	5		4
--	--	---	---	--	---

3	2	1			
---	---	---	--	--	--

ang. *part of Albanian Republic Constitution law article resolution*

9. Shprehja e marrëdhënieve të ngurosura të stereotipizuara ndërmjet objekteve çon në përdorimin e ngurosur të fjalëve shërbyese (gramatikore), kryesisht të parafjalëve, që shënojnë raporte kohore, vendore, qëllimore, shkakore në përbërje të lokucioneve, që marrin formën e shprehjeve të qëndrueshme të karakterit frazeologjik, por pa ndonjë figurshmëri të caktuar. Qëndrueshmëria e lidhjeve dhe ngurtësia e strukturave kushtëzohet nga faktorë jashtëgjuhësorë që lidhen me veçoritë e shprehjes së marrëdhënieve ndërmjet objekteve në mënyrë të ngurtësuar e stereotipe në vetë sferën përkatëse të veprimtarisë shoqërore me funksion parashkruar. Në këtë rast strukturat përkatëse të ngurosura, të cilat kanë në krye të strukturës së tyre (të kokës së frazës) kryesisht një parafjalë përkatëse, mund të mos kryejnë modele nga ana strukturore dhe përmbajtësore, por gjithësesi dalin në tekste të caktuara si njësi të gatshme, individuale, të cilat bëjnë pjesë në kompetencën njohëse e kulturore të ligjëruesit, i cili, që t'i përdorë ato, duhet të jetë njohës i fushës përkatëse. Prandaj ato përvetësohen si të tilla dhe bëjnë pjesë në sistemin gjuhësor (leksikor) të folësit. Në raste të caktuara si njësi të nivelit të gjuhës (të sistemit) ato pasqyrohen në fjalorë terminologjikë të fushës, katalogjizohen në libra të stilistikës funksionale, kur trajtohen si elemente të stilit përkatës etj. Ato janë të ngjashme, të afërta të ndryshme në të tria gjuhët. Kur huazohen nga njëra gjuhë në tjetrën, sidomos nga gjuhët që shërbejnë si modele standardizimi, ato kryesisht përshtaten, por kur janë të ngjashme ndihet (perceptohet) në raste të caktuara "e huaja" kryesisht në formën e

brendshme të strukturës së gjuhës marrëse si psh. *për sa më sipër; për llogari të; nga ana e.*

Në shqipe: *fjalë për fjalë, si i tillë, si vijon*

Në rusishte: *точь в точь, как таковой, следуюцим образом*

Në anglishte: *word for word, as such, as follows*

C. Rrafshi sintaksor

1. Synimi për paraqitje objektive të informacionit të shkencor-teknik me sistemësi të lartë dhe për shprehje të marrëdhënies logjike të strukturuar bën që struktura sintaksore e fjalisë t'i përgjigjet strukturës logjike të gjykimit (SVO).

Në gjuhën angleze kjo lidhet me natyrën e saj me rend të ngulitur të gjymtyrëve kryesore të fjalisë, kurse në gjuhën shqipe dhe ruse ky rregull ka shmangie, por pranohet sigurisht jo si shkelje, por si mundësi për të shprehur të njëjtën përmbajtje në dy rende gjymtyrësh. Megjithatë në këtë rast nuk mund të thuhet se ky përdorim ka të bëjë me çështje stili. Duke nxjerr në pah rastet më tipike në secilën gjuhë duhet theksuar se në gjuhën angleze, si gjuhë me rend të ngulitur gjymtyrësh struktura: *kryefjalë→kallëzues→pjesë plotësuese* ruhet pothuajse në çdo rast. Kjo strukturë ruhet deri diku edhe në gjuhën shqipe, ndonëse në ndonjë rast edhe mund të shkelet, kurse në rusishte rastet e shmangies janë më të shpeshta. Këto shmangie në rusishte vihen re sidomos gjatë përdorimit të foljeve me drejtim të fortë rasor, sidomos foljet që kërkojnë rasën mjetore (*являются, называются*), rasën dhanore (*относиться, принадлежать*) etj. Mund të sillen si shembuj rastet në secilën gjuhë:

Në shqipe: a) *Nga ana tjetër gjykimi paraqitet ... → Gjyqtari vlerëson ... → Vendimi parashikon ...* . b) Raste të rralla: *Vetëm në këtë rast kërkohet zgjidhja nga Gjykata e Apelit.*

Në rusishte: a) Raste mbizotëruese: *Конституционные права ... носят ... → Сам человек может отказаться ... → Такой отказ не может ...*

b) Raste më të rralla: *Субъектом права являются любые лица ... → Представляется необходимым выделить следующие содержания ...*

Në anglishte: *The code goes beyond ... → it does not authorize ...*

2. Shkalla e lartë e objektivitetit të dhënies së informacionit, i shkarkuar nga vlerësimet subjektive vetjake (si në dhënien e informacionit, ashtu edhe në marrjen (perceptimin e tij) bën që njëvetësia e ligjëratës (e fjalisë), e shprehur kryesisht në vetën e tretë njësjës apo shumë (në mungesë të vetës së parë e të dytë njëjës apo shumë), të ndihet si “vetësi e papërcaktuar”, që jo rrallë e shndërron fjalinë në shqipe e në rusishte në pavetore. Në këtë rast ajo ndërtohet me forma modale të thjeshta a të përbëra si *është e domosdoshme* (+ folje në lidhore) *është e nevojshme, është e vështirë, duhet*. Në vartësi nga natyra e gjuhës fjalia mund të jetë pavetore, si në shqipe dhe në rusishte, kurse në anglishte ku zotëron struktura logjike e fjalisë, fjalia shprehet me një përemër me vetë përgjithësuese:

Në shqipe: *Është e domosdoshme për parlamentin të vendosë.*

Në rusishte: *Необходимо чтобы парламент решил*

Në anglishte: *It is indispensable for parliament to decide.*

3. Strukturimi i ngurtësuar i lidhjes së koncepteve dhe shprehja e marrëdhënies të vargëzuara ndërmjet tyre çon në paraqitjen homogjene të gjymtyrëve të fjalisë:

Në shqipe: *...prokurori ka të drejtë të fillojë procesin penal, ... të formulojë akt-akuzën kundër tij, të kryejë hetime në ngarkim të tij, të mbrojë akuzën në ngarkim të tij, si edhe të heqë dorë ose të pushojë akuzën gjatë procesit.*

Në rusishte: *Субъектами права являются: Президент РФ, Совет Федерации, Правительство РФ, Законодательные органы субъектов РФ.....*

Në anglishte: *The material reflected ... to discourage racial discrimination, a policy supported by registative, executive, and judicial action.*

LITERATURA

(1) Arnold J. *The English Word*, Moskva, 1966.

(2) Bali Sh. *Gjuha dhe jeta*, Albatros, Tiranë, 2006.

- (3) Çabej E. *Studime gjuhësore*, III, Rilindja, Prishtinë, 1976.
- (4) Lafe L. *Leksiku terminologjik si problem gjuhësor dhe kombëtar*, në Përmbledhjen "Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe-probleme e detyra", Tiranë, 2009.
- (5) Lloshi Xh. *Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1987.
- (6) Lloshi Xh. *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, Shblu, Tiranë, 2001.
- (7) Piht H. *Terminologjia: An Introduction*, Kopenhagen, 1985.
- (8) Samara M. *Rreth leksikut politiko-shoqëror në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2008.
- (9) Stavileci E. *Terminologjia në administratën publike*, në Përmbledhjen "Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë në probleme e detyra", Tiranë, 2009.
- (10) Shehu E. "Ndikimi i kontakteve ndërgjuhësore mbi formimin dhe zhvillimin e leksikut të së drejtës në gjuhën shqipe", në Konferencën Ndërkombëtare me temë: "Dialogu i gjuhëve, i kulturave dhe i Qyterimeve", Tiranë, 2010.
- (11) Odincov V. *Стилистика текста*. Наука, Москва, 1980.
- (12) Vinogradov V. *Русский язык*, Москва, 1972.
- (13) Vinogradov V. *Стилистика, Теория поэтической речи*. Поэтика, Москва, 1963.